



Pranimar / Dorezuar / Prilidhen / Prilidatohet / Received / Delivery	07-04-2022	2	viti / god / year
Organ / Rrjesia / Organ / Jedinita / Org / Unit	Nr. Prot / Pr. Prot / Prot No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kohësina / Quantity
SKMSTOCK	1949/2022		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOS

A.nr.169/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. Nr. 169/2022, të datës 25.02.2022 të parashtruar nga ankues.

me përfaqësuese juridike avokate me adresë nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Infrastrukturës, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 06.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.169/2022 e datës 25.02.2022 e parashtruar nga ankuesi përmes avokates

A r s y e t i m

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës i punësuar civil në Ministrinë e Infrastrukturës, nëpërmjet përfaqësueses së tij me autorizim më datë 25.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Infrastrukturës për mos zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive lidhur me kompensimin e shujtës ditore dhe pagës jubilarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Infrastrukturës. Më datë 14.03.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Infrastrukturës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 169/2022 me numër protokolli 1000/2022 të datës 25.02.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dëshmi nga posta e Kosovës e datës 10.02.2022; Shkresë e datës 09.02.2022; Kërkesë e datës 09.02.2022; Autorizimi i datës 09.07.2020, nga [redacted] për avokaten [redacted] Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 07.03.2022; Përgjigje në kërkesë e datës 14.03.2022; Akt Emërimi i I.B. i datës 13.04.2012; E-mail nga A.D. për C.Z. i datës 01.04.2022; E-mail nga C.Z. për V.S. i datës 31.03.2022; Lista e Personelit të MI-së 10 dhe 20 vite përvojë pune; Përvoja e punës në shërbimin civil të ankuesit I.B. si dhe pagesat për vitet jubilarë; E-mail nga V.S. për C.Z. i datës 04.04.2022; Dëshmi për pagesën e pagave Jubilarë e muajit Dhjetor 2021 dhe Dhjetor 2013;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të gjitha provave të parashtruar nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit është *e pabazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi [redacted] sipas Akt emërimit të datës 13.04.2012 është i punësuar në Ministrinë e Infrastrukturës, në pozitën *“Udhëheqës i Divizionit të Licencimeve dhe rregullimit Ekonomik”*.

Ankuesi me datë 10.02.2022 përmes postës ka parashtruar kërkesë tek Ministria e Infrastrukturës për kompensimin e pagës jubilarë dhe shujtës ditore për periudhën nga data 09.02.2016 deri me 09.02.2022. Ndërsa me datë 14.03.2022, Njësia e Personelit e Ministrisë së Infrastrukturës, sqaron se sa i përket kërkesës së datës 10.02.2022, përgjigjes lidhur me kërkesën e ankuesit si dhe njoftimit me e-mail të datës 22.02.2022 Divizioni i Personelit nuk i posedon asnjë nga këto dokumente.

Ankuesi nëpërmjet përfaqësueses së tij me autorizim më datë 25.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Infrastrukturës për mos zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive lidhur me kompensimin e shujtës ditore dhe pagës jubilarë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të ofruara nga institucioni punëdhënës, ka konstatuar se ankuesit [redacted] i është kompensuar shpërblimi jubilar në muajin Dhjetor 2013 si dhe Dhjetor 2021, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se organi i punësimit ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë respektivisht me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 ku përcaktohet se: *“Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: shpërblimi i përvojës (jubile)”* si dhe nenin 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: *“Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune”*.



Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit se Ministria e Infrastrukturës nuk respekton Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive lidhur me kompensimin e shujtave dhe pagave jubilarë sipas nenit 52, 53 dhe 54 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, Kolegji ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit dhe si rrjedhojë ka konstatuar së Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014 ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2018. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive pas datës 31.12.2017, andaj mbi këtë bazë, pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar ngase për të punësuarit në shërbimin civil e vetmja formë për kompensimin e shpërblimit të përvjetorit (jubile) është ajo e përcaktuar me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë si dhe me nenin 21 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil. Gjithashtu Kolegji ka marr për bazë edhe nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 ku përcaktohet koha e përshkrimit, prandaj kërkesat e \_\_\_\_\_ edhe sikur të jen të ligjshme janë të parashkruara.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda A.Nr.169/2022**

Çlirim Zeka

  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokates
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Infrastrukturës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

